



Njoftim publik

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa 05 Nr. 351/01-164799/24 dt. 13.12.2024 në emër të aplikuesit/pronarit Isen Sadiku nga Prishtina, për miratimin e kërkesës për plotësimin-ndryshimin e aktit administrativ “Vendim për Leje të Legalizimit për përfundim të ndërtimit” 05 nr. 351/01-230922/22 dt. 22.10.2022, dhe përfshirjen në trajtim edhe të një parcele kadastrale 2886-17 ZK Prishtinë, për legalizimin e ndërtimit ekzistues **B+0** si dhe caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor për vazhdimin të ndërtimit për katin P, 1, 2, 3, 4 dhe 5 për ndërtimin e ndërtesës banimor dhe afarist me etazhitet **B+P+5**, në kuadër të Bllokut urban “**E14-4**”- Tërësisë Hapësinore “**E**”, të Plani Rregullues të Hollësishëm “Kalabria” 2024 - 2032 në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 2886-4 dhe 17 ZK Prishtinë.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data **08.07.2025 deri më 22.07.2025**, në E-mail adresën: urbanizmprihtine@rks-gov.net;

Kushtet e propozuara të ndërtimit:	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Ndërtesa shumë banesore dhe afariste, - B+P+5
b. Vija rregulluese	Sipas planit rregullues
c. Vija ndërtimore	Sipas planit rregullues
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	Sipas vijës ndërtimore
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësorë dhe të pasmë të parcelës kadastrale.	~ 0.5 x H / 0.25 x H sekondare m' (anësore) ~ 0.5 x H / 0.25 x H sekondare m' (anësore) ~ 0.5 x H / 0.25 x H sekondare m' (mbrapa)
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHP)	40% e lejuar. Etazhiet ekzistues
g. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese mbi tokë në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISPNI)	2.40
h. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHGJ)	40 % e lejuar
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHN)	80 % e lejuar Etazhiet ekzistues
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve	VP, të brendshme & të jashtme
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po - ☒ Jo - ☐ Nuk aplikohet - ☐	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe sesa zona përreth? Po - ☐ Jo - ☒ Nuk aplikohet - ☐ Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në zona të mbrojtura, zona të veçanta ose zona të veçanta të mbrojtura? Po - ☐ Jo - ☒ Nuk aplikohet - ☐ Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit administrativ 06/2017, dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, nenin 13, paragrafet 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigje njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.

Nënshkrimi i Zyrtarit: _____